REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I GJEOGRAFISË

Programi: **Bachelor**

Drejtimi: **Gjeografi**

Lënda: HARTOGRAFI TEMATIKE

Pedagogu:	Prof. dr. Pal NIKOLLI
Ngarkesa:	4 ETCS (2 leksione dhe 1 seminar në javë)
Lloji i lëndës:	e detyrueshme
Programi i studimit:	Bachelor, gjeografi
Viti/semestri:	III/II

Përshkrimi: Hartografia tematike si një disiplinë me karakter aplikativ synon t'i pajisë studentët me konceptet dhe teknikat që udhëheqin projektimin dhe përftimin e hartave tematike analoge dhe numerike. Ligjëratat ofrojnë edhe një hyrje në konceptet kyçe statistikore dhe hartografike (gjeovizualizimi dhe komunikimi), ndërsa seancat ushtrimore u mundësojnë studentëve komunikimin e informacionit gjeografik nëpërmjet hartave tematike me anën e ARCGIS. Pjesëmarrja në ligjërata është e nevojshme ndërsa në seancat ushtrimore e detyrueshme.

Temat e leksioneve:

1. Objekti, detyrat dhe qëllimi i Hartografisë Tematike (HT). Lidhjet e HT me shkencat gjeografike. Pasojat e ndryshimeve teknologjike në hartografi. Kërkesa bashkëkohore që duhet të plotësojnë hartat dhe atlaset
2. Hartat tematike dhe llojet e tyre. Përmbajtja e hartave tematike
3. Metodat e krijimit të hartave tematike,
4. Hartografimi automatik. Tipet dhe modelet e të dhënave. Baza e të dhënave.
5. Hartografimi koroplet, izoritmik, simbol pikë proporcional, me pika dhe deizimetrik
6. ARCGIS DESKTOP dhe përbërësit e tij. Tipet e hartave ArcGIS
7. Etapat e krijimit të hartave tematike me anën e ArcGIS. Principet e simbolizimit

8. Hartografimi i mjedisit dhe i zonave bregdetare
9. Hartografimi urban dhe rural
10. Hartografimi i turizmit dhe i monumenteve natyrore
11. Hartografimi i ndotjeve e zhurmave. Hartografimi i etnive dhe i strukturës e komuniteteve fetare.
12. Hartografimi i rrezikut natyral e teknologjik. Analiza e rreziqeve të erozionit potencial dhe real. Modelimi i erozionit të tokave nga rrjedhja e ujrave.
13. Hartografimi i rrezikut të zjarrit, përmbytjeve dhe tërmeteve.
14. Formulimi i hartës tematike në ArcGIS dhe printimi i saj.

Forma e kontrollit dhe vlerësimit

- *Detyrim frekuentimi në*: 70% të seminareve

- *Angazhimi në seminare:* 10% e notës

-- *Detyra e kursit*: rreth 5 faqe format A4, TNR, 12, hapësira 1.5): 20% e notës

- *Kontrolli përfundimtar:* provim me shkrim 70% e notës

- Gjithsej: 100%

Literatura bazë:

1. Pal Nikolli: *Hartografia tematike (cikël leksionesh). Tiranë, 2016*
2. Agim Shehu**, Pal Nikolli**: HARTOGRAFIA TEMATIKE. SH. BOTUESE "PROGRES", TIRANË, 2007,
3. Agim Shehu**, Pal Nikolli**: Elemente të Hartografisë, SHBLU, Tiranë 2005
4. **Pal Nikolli**: Krijimi i hartave tematike me anën e ArcGIS. Sh. Botuese "Klean", Tiranë, 2013
5. **Pal Nikolli**: Hartografia (Ushtrime dhe Praktika Mësimore), Tiranë, 2012
6. A. Shehu, **P. Nikolli**. "Historia e Hartografisë Shqiptare", Tiranë 2001.
7. Terry A. Slocum, Robert B. McMaster, Fritz C. Kessler, and Hugh H. Howard. *Thematic Cartography and Geographic Visualization*, *Third Edition* (2009) NJ: Prentice Hall.